



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 11.05.2023

Nr: 98

Ora: 16:25

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 26, DATË 10.05.2023 TË KOMISIONERIT  
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Arben Qafa, drejtor i Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”, Berat.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



## VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni ndaj z. Arben Qafa, drejtor i Qendrës Kulturore “Margarita Tutulani”, Berat, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 26 regj., datë 10.05.2023. Në mbledhjen e datës 11.05.2023, ora 16:25, pas relativitetit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa nr. 26 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 26, datë 10.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 12.05.2023, ora 14:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

**Elvis**                      **ÇEFA**                      -                      **Relator**

**Ilirjan**                      **RUSMALI**                      -                      **Anëtar**

**Koli**                      **BELE**                      -                      **Anëtar**